

LIGJI NR. 07/L - 016**PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE - COVID-19**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE - COVID-19**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Ligji është plotësimi dhe ndryshimi i ligjeve të përcaktuara në dispozitat e mëtejme të këtij ligji, me qëllim të mundësimit të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia COVID-19.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të cilat janë të obliguara të zbatojnë masat e parapara në këtë ligj.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Pandemia (Covid-19)** - pandemia e shpallur më 11 mars 2020 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si pasojë e shfaqjes së virusit SARS-CoV-2, i njohur si koronavirus; dhe

1.2. **Rimëkëmbja Ekonomike** - masat e marra nga institucionet e Republikës së Kosovës me qëllim të zvogëlimit të ndikimit të pandemisë në ekonominë dhe në jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, si dhe mundësimin e ri-alokimit të resurseve dhe stimulimit të rritjes së aktivitetit ekonomik.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në ligjet të cilat plotësohen dhe ndryshohen me këtë ligj.

KAPITULLI II

PLOTËSIM NDRYSHIMET LIGJORE PËR MASAT PËR RIMËKËMBJE TË EKONOMISË

Neni 4

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

1. Neni 1, paragrafi 2., i Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (këtu e tutje: LTHFKGK), shtohet teksti si në vijim:

Përfundimisht, për vendosjen e skemave dhe produkteve të reja me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike sipas dispozitave të këtij ligji, FKGK vetëm e njofton BQK-në.

2. Neni 3, paragrafi 1., pas tekstit në nën-paragrafin 1.14. i LTHFKGK-së, shtohet teksti si në vijim:

Përfundimisht, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, FKGK autorizohet të lëshojë garanci kreditore me përqindje të mbulesës deri në tetëdhjetë për qind (80%).

3. Neni 3, paragrafi 1., pas tekstit në nën-paragrafin 1.21. i LTHFKGK-së, shtohet teksti si në vijim:

Përfundimisht, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, FKGK lëshon garanci për kredi me destinim zhvillimin e biznesit për fermerët e regjistruar në mënyrë të rregullt në regjistrin e fermerëve që mirëmbahet nga ministria përgjegjëse për bujqësi dhe të pajisur me Numër Identifikues të Fermës (NIF), edhe në rastet kur fermeri përkatës nuk ka të regjistruar shoqëri tregtare në ARBK.

4. Pas nenit 5 të LTHFKGK, shtohet një nen i ri me numrin rendor 5A, me tekstin si në vijim:

Neni 5A

Autorizimet e FKGK-së për rimëkëmbje Ekonomike

1. FKGK në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përgatit dhe i vendos në treg produkte dhe shërbime të reja ose produkte dhe shërbime përcjellëse për arritjen e qëllimit të rimëkëmbjes ekonomike.

2. Përqindja e mbulesës për garancitë kreditore që lëshohen nga FKGK mbi kufirin sipas nenit 3, paragrafit 1.14. të këtij Ligji, përcaktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve të FKGK për secilën dritare të re që krijohet me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, si dhe mund të aplikohet edhe për dritaret dhe kapitalin ekzistues që menaxhohet nga FKGK.

3. Të gjitha fondet e transferuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në FKGK për qëllime të rimëkëmbjes ekonomike, do të trajtohen si asete të përhershme të FKGK-së.

5. Neni 8 i LTHFKGK, pas paragrafit 1. shtohet një paragraf i ri me numrin rendor 1A, me tekstin si në vijim:

1A. Nëse është e nevojshme për mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të FKGK, Qeveria e Republikës së Kosovës, me kërkesë të FKGK, do të mbulojë plotësisht ose pjesërisht tarifatat për shërbimet e FKGK ndaj institucioneve financiare.

Neni 5

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116

1. Neni 7 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116 (këtu e tutje LFPK), në fund të paragrafit 2., i shtohet teksti si në vijim:

Përrjashtimisht, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, pjesëmarrësit mund t'i tërheqin dhjetë përqind (10%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK, në përputhje me nenin 12A të këtij ligji. Mjetet e tërhequra nga pjesëmarrësit sipas këtij neni, e të cilët kanë kursime deri në nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro (9.999.00 euro) kompensohen në formë rimbursimi, duke filluar nga viti 2023, sipas formulës dhe metodologjisë së rimbursimit që vendoset me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në konsultim me Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Pas nenit 12 të LFPK-së, shtohet neni i ri me numrin rendor 12A, me tekstin si në vijim:

Neni 12A

Pagesa e kursimeve individuale pensionale për rimëkëmbje ekonomike

1. Pjesëmarrësit mund t'i tërheqin dhjetë për qind (10%) të kursimeve të tyre pensionale në FKPK apo në Fondet Pensionale, me rastin e krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia.

2. Me qëllim të tërheqjes së mjeteve sipas paragrafit 1. të këtij neni, pjesëmarrësit aplikojnë në formë elektronike pranë FKPK-së brenda katër (4) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çdo aplikacion që merr FKPK në formë elektronike e trajton atë si të mirëqenë dhe zyrtare, dhe shqyrton kërkesën sipas dispozitave të këtij neni. Procedura e aplikimit zhvillohet sipas procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.

3. Aplikacioni sipas paragrafit 2. të këtij neni është i kushtëzuar me pëlqimin e aplikantit për përpunimin e të dhënave të tij, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Me kërkesë të FKPK-së, BQK-ja, Agjencia e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Thesari i Kosovës dhe institucionet tjera relevante, si dhe bankat komerciale të licencuara nga BQK ndajnë të dhënat e nevojshme të pjesëmarrësve, me qëllim të shqyrtimit të kërkesave.

5. Mjetet nga kërkesat e aprovuara nga FKPK transferohen në llogaritë bankare të përfituesve në bankat komerciale të licencuara nga BQK-ja dhe tërheqja e mjeteve bëhet vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

6. Pagesa e mjeteve të aprovuara bëhet në bazë të numrit, çmimit dhe vlerës së njësisë që ka çdo aplikant në llogarinë e tij personale në FKPK në ditën e aplikimit, përfshirë këtu ndryshimet eventuale në çmimin e njësisë deri në datën e pagesës.

7. Mjetet e tërhequra sipas këtij neni, janë të përjashtuara nga tatimi në të ardhurat personale.

Neni 6

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L - 028 për Tatimin në të Ardhurat Personale

1. Neni 8 i Ligjit Nr. 05/L -028 për Tatimin në të Ardhurat Personale (këtu e tutje LTAP), pas nën-paragrafit 1.27., shtohet nën-paragrafi me numër rendor 1.28. me tekstin si në vijim:

1.28. Paratë e tërhequra nga FKPK apo në Fondet Pensionale për rimëkëmbje ekonomike.

Neni 7

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

1. Neni 26 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (këtu e tutje LTVSH), pas nën-paragrafit 2.13. shtohet një nën-paragraf i ri, me numrin rendor 2.14., me tekstin si në vijim:

2.14. furnizimet e hoteleve, restoranteve dhe shërbimet e ushqimit.

2. Neni 28 i LTVSH-së, pas nën-paragrafit 1.12. shtohet një nën-paragraf i ri, me numrin rendor 1.13., me tekstin si në vijim:

1.13. transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore bazuar në kriteret që përcaktohen me vendim nga Ministri i Bujqësisë. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministri i Financave me vendim përcakton procedurat dhe kriteret.

3. Në Kapitullin X "Iirimet në eksportim", në nenin 31, paragrafin 1., të Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, pas nën-paragrafit 1.5., shtohet nën-paragrafi i ri 1.6., me tekstin si vijon:

1.6. Lënda e parë e cila prodhohet nga veprimtaritë biznesore të regjistruara dhe aktive në Republikën e Kosovës, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit apo jo, lirohet nga TVSh.

Neni 8

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L- 221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007

1. Neni 22.A. i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L- 221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007 (këtu e tutje LMFPF), në fund të paragrafit 6. shtohet teksti si në vijim:

Përrjashtimisht, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, mjetet e privatizimit mund të përdoren për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me qëllim të realizimit të rimëkëmbjes ekonomike, përrjashtuar kategorinë e pagave dhe shtesave.

2. Neni 22A i LMFPF-së, pas paragrafit 7.2., shtohet teksti si në vijim:

Megjithatë, ky përrjashtim nuk zbatohet për vitin 2020 dhe 2021.

Neni 9

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L- 102, me Ligjin 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 04/L-223

1. Neni 28 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-102, me Ligjin 04/L-115 dhe me Ligjin Nr. 04/L-223, pas paragrafit 7., shtohet paragraf i ri me numrin rendor 8, me tekstin si në vijim:

8. Përrjashtimisht nga dispozitat tjera të këtij neni, lirohen nga interesi tatimpaguesit që kane obligime tatimore të pa paguara që kanë ndodhur prej 01.01.2020 nëse deri më 31.12.2020 i paguajnë të gjitha obligimet tatimore bazë, në bazë të marrëveshjes me ATK-në për pagesën e obligimeve.

Neni 10

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 05/L-080 dhe me Ligjin Nr. 06/L-023

1. Neni 2, paragrafi 6. i Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 05/L-080 dhe me Ligjin Nr. 06/L-023 (këtu e tutje LAKP), pas tekstit "dhe përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit" shtohet teksti si në vijim:

si dhe për financimin e rimëkëmbjes ekonomike.

2. Neni 2, paragrafi 7. i LAKP-së, pas tekstit "të cilat fonde të përrkohshme përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit", shtohet teksti si në vijim:

si dhe për financimin e rimëkëmbjes ekonomike.

Neni 11**Përkrahja e ndërmarrjeve private**

1. Të gjitha bizneset të cilat kanë qenë të mbyllura apo kanë pasur problem të funksionimit të rregullt gjatë kohës së pandemisë, por të cilat kanë qenë aktive në regjistër të Administratës Tatimore të Kosovës, para datës 29 shkurt 2020, mbështeten financiarisht nga ana e buxhetit të Republikës së Kosovës me mjete monetare për t'i mbuluar shpenzimet operative në shumën prej dyqind milion euro (200,000,000 euro).

Neni 12**Pagat e punëtorëve në sektorin privat**

1. Paguhen, nga ana e Buxhetit të Republikës së Kosovës, pagat e punonjësve në sektorin privat për periudhën tetor - dhjetor 2020 të cilët si pasojë e pandemisë COVID-19, janë larguar apo pezulluar nga puna e tyre për periudhën jo më të shkurtër se tre(3) muaj, pas datës 29 shkurt 2020, e deri më 30 dhjetor 2020.

2. Shuma e pagesës për punëtorët nga paragrafi i 1. i këtij neni, është treqind euro (300 euro) për një(1) muaj.

Neni 13**Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068**

1. Të shtohet nen i ri,

Përparësitë për prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore përgjatë pandemisë COVID -19

1. Gjatë vlerësimit të ofertave, të cilat janë dorëzuar nga prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore, kontratave të furnizimit për punë apo ofertuesve vendor, që në ofertë përmbajnë vetëm produkte dhe shërbime vendore, do t'i jepet përparësi krahas ofertave të ofertuesve me produkte dhe shërbime të huaja, në rast se diferenca në mes të këtyre ofertave nuk është më e lartë se dhjetë (10) pikë.

2. Në rast se kriter për dhënie të kontratës është çmimi më i ulët, atëherë i jepet preferencë ofertuesit vendor me produkte dhe shërbime vendore, në rast se çmimi i po të njëjtës nuk është më i lartë se pesëmbëdhjetë për qind (15%) në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.

Neni 14**Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158**

1. Neni 51 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, pas paragrafit 3. shtohet një paragraf i ri me numër rendor 4., me tekstin si në vijim:

4. Përrjashtimisht nga neni 50 i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, lirohen nga pagesa e rentës minerare prej datës 1 Janar 2021 deri me 31 Maj 2021 të gjitha subjektet që obligohen të paguajnë këtë rentë.

Neni 15**Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë**

1. Neni 15 i Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.1.2., shtohet një nën-paragraf i ri me numër rendor 1.1.2.a., me tekstin si vijon:

1.1.2.a. Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, subvencionon tarifën e Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme (BRE) për të gjithë konsumatorët për pesë (5) muaj për periudhën 01 janar 2021 deri me 31 maj 2021.

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Vlefshmëria e Ligjit

1. Ky ligj mbetet në fuqi deri më 31.12.2021, përjashtimisht dispozitave të nenit 5, i cili zbatohet deri më 31.12.2028 dhe nenit 7 paragrafit 3.
2. Pas datës 31.12.2021 të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 07/L-016
4 Dhjetor 2020

Shpallur me dekretin Nr. DL-171/2020, 05.12.2020 nga u.d. Presidentja e Republikës së Kosovës
Vjosa Osmani-Sadriu